

## Halloween and Bonfire Night information for families in Albanian

Halloween dhe Nata e Zjarrit të Madh janë të dyja tradita shumë të vjetra që festohen në Angli. Këto evenimente mund të jenë argëtuese për familjet por mund të jenë edhe të zhurmshme e paksa të frikshme nëse nuk jeni të sigurt se çfarë po ndodh.

Halloween zhvillohet zyrtarisht më 31 tetor por mund të festohet edhe përpara apo pas kësaj date.

Do të shihni zbukurime drithëruese dhe njerëz, kryesisht fëmijë, të veshur me kostume. Kostumet duken pak të frikshme dhe mund të shihni shtriga, skelete, mumje dhe përbindështa të tjerë.

Sapo errësohet mund të dëgjoni familjet dhe të rinjtë në rrugë. Në mbrëmje, njerëzit trokasin në dyert e të tjerëve dhe thonë "trick or treat" (dredhi apo qerasje). Shumë njerëz u japin vizitorëve ëmbëlsira. Këta vizitorë nuk janë ftuar në shtëpi. Nëse nuk dëshironi mund të mos e hapni derën.

Jo të gjithë e festojnë Halloween dhe pjesëmarrja varet nga ju.

Nata e zjarrit të madh festohet zyrtarisht më 05 nëntor, por mund të festohet edhe para ose pas kësaj date, duke ndezur zjarre dhe duke hedhur fishekzjarre.

Mund të dëgjoni zhurma të forta në mbrëmje dhe gjatë natës. Gjithashtu mund të dëgjoni më shumë njerëz se zakonisht.

Në mbrëmje mund të prisni të shihni fishekzjarre dhe shumë tym. Shumë familje marrin pjesë në zjarret e organizuara edhe mund të shihni një person të quajtur Guy që shtiret sikur qëndron mbi zjarr.

Do të nuhatni erën e fishekzjarreve dhe tymin e zjarreve.

Shumë njerëz përdorin fishekzjarre për të festuar raste të ndryshme. Mund të dëgjoni zhurma të forta, të shihni ndriçim dritash në qiell dhe t'i nuhatni këto në periudha të ndryshme të vitit.